

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	REL: Çka i karakterizoi 14 vjetët e Vuçiçit në pushtet?
ADRESA	https://dosja.al/bota/rel-ka-i-karakterizoi-14-vjetet-e-vucicit-ne-pushtet-i516582
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 18:17:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 18:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	59cd4e7e749526644024814c30d0613e470762686899e1cb4a55dc5b072806aa
TEKSTI	78ad0083be68655930dc80364c66057ca9c15e9bab19066e73b6a24a5777011a
PAMJA	ef491371dbe78cfe3520fed06075072cbb17f4a68512329ea347f80f1ee18b54

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	90a9da84fb7e9d7fb2c149db25fe21c06f93a267320bb222744eb010521afbbb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/90a9da84fb7e9d7fb2c149db25fe21c06f93a267320bb222744eb010521afbbb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

9 MINUTA ME PARE

121 ditë revoltë kundër Edi Ramës/
Protestuesit masazh kryeministrit me
pankarta: Asgjë s'të ndal për të vjedhur, por
SPAK-u ka për ta mbledhur

36 MINUTA ME PARE

Debate për territorialen te "Ligjet"/
Rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e
draftit të saj në rend dite! Manja: Nuk e
kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën

6 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e
gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e
Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë
punën për ligjin e pagave

8 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder
tregon detyrat: Kapitujt duhen
mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në
balltë, do jetë dështim

Bota

REL: Çka i karakterizoi 14 vjetët e Vuçiçit në pushtet?

Një dekadë e gjysmë më vonë, ai e braktisi postin e presidentit të Serbisë dhe iu fut garës zgjedhore për postin e kryeministrit, pas dy vjetësh protestash dhe kërkesash për zgjedhje të parakohshme.

dosja

28 Shtator 2026, 20:10
Nga G.M



Aleksandar Vuçiç largohet nga Presidencia e Serbisë pasi dha dorëheqjen më 27 shtator 2026.

Ish-radikal i Vojsllav Sheshelit dhe ministër i Slobodan Millosheviqit, Aleksandar Vuçiçi gjatë dekadës së kaluar, si zyrtar i Partisë së re Përparimtare të Serbisë, u orientua drejt Perëndimit dhe u bë partner i tij. Një dekadë e gjysmë më vonë, ai e braktisi postin e presidentit të Serbisë dhe iu fut garës zgjedhore për postin e kryeministrit, pas dy vjetësh protestash dhe kërkesash për zgjedhje të parakohshme.

"Në vitet e para ai premtoi disa ndryshime dhe ne, si shoqëri, besuam se kishte mësuar diçka nga vitet '90, por në fund gjithçka përfundoi në diçka që i ngjan shumë viteve '90", thotë Dushan Spasojeviq nga Fakulteti i Shkencave Politike në Beograd.

Në vitet e fundit, vlerëson Spasojeviqi, shohim "prirje autoritare, punë të papërfunduara, korrupsion dhe premtime të pareallzuara". Vdekja e 16 njerëzve nga shembja e strehës në stacionin hekurudhor në Novi Sad nxiti protesta masive dhe kërkesa për përgjegjësi nga pushteti.

Protestuesit, të udhëhequr nga studentët në bllokadë, kërkuan ndryshimin e pushtetit, duke vlerësuar se puna e dobët për rindërtimin e asaj strehe dhe korrupsioni kishin shkaktuar atë tragjedi. Serbia nën udhëheqjen e Vuçiçit ka shënuar rënie të lirive, gjë që është theksuar edhe në raportin e fundit të organizatës ndërkombëtare, Freedom House.

Në atë raport, Serbia është renditur ndër vendet me rënien më të madhe të lirive të njeriut. Ndërkohë, Serbia ka ngecur në integrimet evropiane, duke kaluar nga fillimisht një prej vendeve prijëse, së bashku me Malin e Zi, pothuajse në fund të listës. Që nga fundi i vitit 2021, nuk është hapur asnjë kapitull në negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Rënia e demokracisë, marrëdhëniet e pazgjidhura me Kosovën dhe, mbi të gjitha, mosvendosja e sanksioneve ndaj Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës, janë arsyt kryesore për këtë ngecje. Duke dhënë dorëheqjen tetë

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një
konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 16:51

Reforma territoriale/ Këshilli
Bashkiak i Belshit voton
kundër bashkimit me
Elbasanin

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet
Ramën për Ergys Agasin,
kryeministri largohet me
shpejtësi pas gardës

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 13:01

muaj para përfundimit të mandatit, Vuçiçi tha më 27 shtator se e di se ka gabuar në vendime të ndryshme.

"Që nga përzgjedhja e njerëzve, ndonjëherë edhe në aspektin strategjik, por, më duket, kam arritur ta korrigjoj këtë, ndërsa në aspektin taktik sigurisht shumë më shpesh", deklaroi ai, pa specifikuar se për cilat vendime e kishte fjalën.

Çfarë (nuk) bëri ai?

"Vuçiçi është dikush që ka premtuar shumë", thotë politologu Dushan Spasojeviç, duke shtuar se në vitet e para ai "bëri gjëra të rëndësishme për Perëndimin".

"Marrëveshja e Brukselit ishte një gjë e madhe, dhe ende është gjë e madhe, ende është themeli i marrëdhënieve të Serbisë me Kosovën", thotë ai.

Por Spasojeviçi thotë se me kalimin e kohës, mungesa e integriteteve të mëtejshme dhe veçanërisht "ritja e tendencave autoritare dhe korrupsioni e minuan pozitën nga e cila Vuçiçi u nis". Me Marrëveshjen e Brukselit më 2013 për normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, u arrit pajtueshmëri për integrimin e serbëve të Kosovës në sistemin kosovar të drejtësisë dhe policisë.

Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë deri më sot nuk është zbatuar. Në Uashington u nënshkruan edhe marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në vitin 2020, si dhe ajo e Ohrit në pranverën e vitit 2023, e cila duhej të çonte drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Ndërkohë, procesi i negociatave mes Serbisë dhe Kosovës ka ngecur, për çka të dyja palët fajësojnë njëra-tjetrën. Ndodhi edhe sulmi i armatosur i një grupi serbësh të Kosovës në Banjskë, në veri të Kosovës, në shtator të vitit 2023, për të cilin Prishtina fajëson Serbinë, gjë që Beogradi e mohon.

Gjatë dy viteve të fundit, Kosova ka mbyllur pothuajse të gjitha institucionet e Serbisë që funksiononin në zonat e banuara me serbë gjatë periudhës së pasluftës. Spasojeviçi vlerëson se në fillim Perëndimi e shihte Vuçiçin si dikë që mund të artikullonte një qëndrim të djathtë në Serbi, patriotik ose nacionalist, në mënyrë që ai të ishte i pajtueshëm me Perëndimin.

"Kjo ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për ta dhe mendoj se edhe për këtë arsye e mbështetën fuqishëm. Plus, këtu duhet shtuar edhe zhgënjimi me Tadiqin, i cili gjithashtu kishte një mundësi të mirë nga këndvështrimi i tyre", tha ai.

"Ndërsa sot kemi ardhur në një situatë ku ai ka mbështetje protokollare dhe vetëm sepse nuk ka një alternativë të qartë", shtoi ai.

Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2012, demokrati Boris Tadiq humbi mbështetjen e votuesve, ndërsa Partia Përparimtare Serbe formoi shumicën në Kuvendin e Serbisë.

Me kë ishte më i afërt Vuçiçi?

Politologu Spasojeviç thotë se Vuçiçi "luan disa karta", duke përkshruar politikën e tij të jashtme. Spasojeviçi vëren se, teksa gjërat filluan të ndryshonin në BE, Vuçiçi filloi gradualisht të orientohej më shumë drejt të tjerëve, të fliste sërish për miqësinë me Rusinë dhe të theksonte Kinën si një lloj alternative.

"Kjo i dha atij një hapësirë manovrimi, në njëfarë mënyre 'ia rriti edhe çmimin' në një moment, por tani e ka sjellë në një situatë mjaft të pakëndshme", vlerëson Spasojeviçi.

Vuçiçi e përfundoi mandatin e tij me një bisedë telefonike me presidentin rus, Vladimir Putin, duke pritur zgjatjen e marrëveshjes për gazin. BE-ja, edhe lidhur me këtë bisedë, e paralajmëroi Serbinë se marrëdhëniet me Rusinë nuk mund të zhvillohen sikur gjithçka të jetë si më parë me regjimin e Putinit, në hijen e luftës agresore të Rusisë kundër Ukrainës.

Edhe në Uashington, me këtë rast, iu referuan deklaratës së fundit të sekretarit të Shtetit, Mark Rubio, më 23 shtator, se Serbia është e përfshirë në disa çështje që janë potencialisht problematike dhe shpërthyes, dhe që janë me interes ndërkombëtar.

"Tani kemi presion të kryqëzuar ndaj të gjithë miqve të Rusisë dhe Kinës, si nga Uashingtoni, ashtu edhe nga Brukseli. Natyrisht, Vuçiçi mund të rrezikojë dhe të kthehet te qasjet e tij radikale dhe të shohë se çfarë do t'i sjellë kjo", thotë Spasojeviçi.

Ai vlerëson gjithashtu se balancimi që përdor Vuçiçi është relativisht i qëndrueshëm për sa kohë askush në vend nuk e kundërshton seriozisht, por se në një rast të tillë gjërat bëhen më të komplikua.

FOTOLAJM/ Kush janë dy te rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

më të klikuarat

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

WSJ zbardh prapaskenat: Ja si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 mld \$ në Shqipëri

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by  tomorrow

A është jeta më mirë tani?

Aleksandar Vuçiqi, jo vetëm si kryeministër, por edhe si president, shpesh ka përdorur shifra për të argumentuar se sa më mirë jetohet, punohet dhe ndërtohet tani se para vitit 2012. Duke dhënë dorëheqjen, ai tha se do të përpiqet të mos i bezdisë njerëzit me shifra.

Por, duke paraqitur disa shifra, ai vlerësoi se Serbia është një vend me borxh të ulët, "me borxh dy herë më të vogël sesa vendet më të zhvilluara të BE-së". Ai veçoi, siç pretendon, se janë hapur mbi 300 fabrika dhe uzina vendore dhe të huaja, si dhe se ka madje 500.000 njerëz më shumë të punësuar zyrtarisht sesa në vitin 2012.

Megjithatë, profesori i ekonomisë në Fakultetin FEFA në Beograd, Goran Radosavljeviq, thotë se rritja e pagës mesatare, e cila ka arritur në 1.000 euro, nuk do të thotë edhe se serbët jetojnë më mirë tani. Siç shpjegon ai, rritja e çmimeve të ushqimit gjatë gjashtë apo shtatë vjetëve të fundit ka qenë shumëfish më e madhe sesa rritja e pagave.

"Paga realisht rritet, por 50, 60 përqind të shportës së konsumit e shpenzoni për ushqim, ndërsa ushqimi është rritur me dy shifra gjatë viteve të fundit", thotë ai.

Radosavljeviq thekson gjithashtu se të dhënat tregojnë se qytetarët janë futur shtatë herë më thellë në borxh në formën e kredive afatshkurtra sesa para rreth dhjetë vjetëve. Si dështim ai e konsideron edhe faktin se, siç thotë, nuk janë zhvilluar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vendore.

"Nuk arritëm që as për ato pak kompani të mëdha që erdhën këtu, t'i lidhim disa nga ndërmarrjet tona të vogla dhe të mesme me to", shtoi ai.

Për investimet e huaja, të cilat ishin një nga argumentet kryesore të pushtetit në zgjedhje, Radosavljeviq thotë se ato kanë ngecur gjatë dy-tri vjetëve të fundit për shkak të mungesës së fuqisë së lirë punëtore. Ai konsideron se investimet e shtetit në infrastrukturë dhe projekte të mëdha ndërtimore "e rrisin PBB-në në afat të shkurtër, por se në afat të gjatë nuk sjellin pothuajse asgjë ose shumë pak". Si problem ai përmend edhe shkallën e lartë të korrupsionit.

Sipas raportit të organizatës Transparenca Serbi dhe rrjetit global Transparency International për vitin 2025, Serbia renditet në vendin e 116-të nga 182 vende të botës në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit. Ndërsa si rezultat pozitiv të pushtetit të tanishëm ai e vlerëson kursin e qëndrueshëm të këmbimit, duke thënë se kjo ka qenë në dëm të një dekurajimi të madh të eksporteve vendore.

Vuçiqi përballë një "sfide serioze"

Pas 14 vjetësh në pushtet, Vuçiqi për herë të parë përballlet me një sfidë serioze në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 25 tetorit.

"Kjo është një provë jashtëzakonisht serioze për të. 25 tetori është padyshim sfida më e madhe, pa asnjë dilemë, që kur erdhi në pushtet", konsideron Spasojeviq.

Nëse, megjithatë, arrin të bëhet kryeministër, Spasojeviq nuk pret që Perëndimi menjëherë të ushtrojë presion me të gjitha forcat.

"Por sigurisht se pozita e tij do të jetë shumë më e vështirë sesa ishte pesë apo dhjetë vjet më parë", konsideron ai.

Lista e pjesëmarrësve në zgjedhjet parlamentare ende nuk është përfunduar, ndërsa si rivalja më serioze e Vuçiqit dhe Partisë së tij Përparimtare Serbe konsiderohet lista "Studentët fitojnë". Këtë listë e mbështesin studentët protestues, të cilët udhëhoqën protestat dhe organizuan bllokada disamujore të fakulteteve në mbarë vendin./REL

aleksander vucic

rel

Sondazh

Poll

Bota

28 Shtator 2026, 19:45

"Moska po përpiqet të krijojë pasiguri"/ Komandanti i NATO-s: Rusia synon të dobësojë vullnetin e aleatëve për të mbështetur Ukrainën

Alexis Grinkevich RUSI- Rusia po përdor një sërë veprimesh hibride me synimin për të dobësuar vendosmërinë e ...

Pas bisedës Vuçiç-Putin, Departamenti i Shtetit rikujton deklaratën e Rubios për çështjet problematike

Bota

28 Shtator 2026, 17:57

Kongresistë republikanë kërkojnë të mos i zgjatet licenca Industrisë së Naftës së Serbisë

Bota

28 Shtator 2026, 17:55

Kërkoi masa kundër Ebolës, politikani në Kongo rrihet për vdekje dhe i digjet shtëpia

Bota

28 Shtator 2026, 17:20

Komediani turk dënohet me 19 muaj burg për fyerje ndaj Erdoganit, përdori termin 'diktator' në një shfaqje humoristike

Bota

28 Shtator 2026, 17:03

Bleta

28 Shtator 2026, 16:17

“Mund të rrëzojmë çdo qeveri që duam”/ Deklarata e ambasadores amerikane shkakton polemika në

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.